

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Elektropompa uji”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Pompa Uji
42122130 – 0**

FONDIT LIMIT: 1.167.030 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; përkatësisht në vlerën 23.340 (njetzet e tre mije e treqind e dyzet) leke*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, paragrafi c), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenit 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, të ndryshuar.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006)“Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026).**

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respektive të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se

mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose te distributorit të autorizuar, në rast se nuk është prodhues. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurorimi

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedën teknike (Technical Data Sheet) të elektropompës së ofruar, të lëshuar ose publikuar nga prodhuesi, në të cilën të jenë të pasqyruara qartë karakteristikat dhe parametrat teknikë të pajisjes.

Skeda teknike duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e elektropompës së ofruar, përfshirë prodhuesin, markën/modelin, prurjen (Q), lartësinë manometrike (H), fuqinë e motorit, tensionin/frekuencën e punës, materialet kryesore të ndërtimit dhe parametrat e tjerë teknikë të kërkuar në specifikimet teknike, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së produktit të ofruar me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Skeda teknike e paraqitur duhet të mundësojë identifikimin e qartë të modelit të ofertuar dhe verifikimin e karakteristikave teknike të ti

.Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1, si dhe njoftimit të APP-së nr.prot 7459/4, datë 25.05.2021.

Argumentimi teknik i kriterit

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë **skedën teknike (Technical Data Sheet)** të **elektropompës së ofruar, të lëshuar ose publikuar nga prodhuesi**, është vendosur me qëllim që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësi të verifikojë në mënyrë objektive dhe të dokumentuar përputhshmërinë e pajisjes së ofertuar me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Elektropompa përbën pajisjen kryesore të objektit të prokurimit dhe karakteristikat e saj teknike, veçanërisht **prurja (Q), lartësia manometrike (H), fuqia e motorit, tensioni dhe frekuenca e punës, materialet e ndërtimit, si dhe parametrat e tjerë funksionalë**, ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetin, performancën, qëndrueshmërinë dhe përshtatshmërinë e pajisjes për kushtet konkrete të punës.

Paraqitja e skedës teknike të prodhuesit është e nevojshme për të mundësuar **identifikimin e saktë të prodhuesit, markës dhe modelit konkret të ofertuar**, si dhe për të shmangur vlerësimin e ofertës vetëm mbi bazën e deklarimeve të vetë operatorit ekonomik, të cilat nuk do të ishin të mjaftueshme për verifikimin teknik të pajisjes.

Nëpërmjet këtij dokumentacioni, Autoriteti Kontraktor mund të krahasojë në mënyrë të drejtpërdrejtë parametrat e deklaruar nga prodhuesi me kërkesat minimale të specifikimeve teknike dhe të vlerësojë nëse elektropompa e propozuar është e përshtatshme për destinacionin dhe kushtet e parashikuara të përdorimit.

Gjithashtu, identifikimi i qartë i modelit të ofertuar garanton që dokumentacioni teknik i paraqitur i referohet pikërisht pajisjes që operatori ekonomik angazhohet të furnizojë dhe jo një produkti tjetër të së njëjtës markë apo familje produktesh.

Për sa më sipër, kriteri konsiderohet **i nevojshëm, proporcional dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit**, pasi synon verifikimin e përputhshmërisë teknike dhe funksionale të elektropompës së ofertuar me kërkesat e Autoritetit Kontraktor, si dhe garantimin e furnizimit me një pajisje që plotëson parametrat e kërkuar për funksionimin e saj sipas destinacionit.

2.7 Operatoiri ekonomik duhet të paraqesi **Deklaratën e Konformitetit** për elektropompën e ofruar, të lëshuar nga prodhuesi ose subjekti përgjegjës sipas legjislacionit të zbatueshëm, nëpërmjet së cilës deklarohet përputhshmëria e produktit me kërkesat, direktivat/rregulloret dhe standardet teknike të aplikueshme.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për tu siguruar se operatori do të përmbush kërkesat e AK

Argumentimi teknik i kriterit

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë **Deklaratën e Konformitetit (Declaration of Conformity)** për elektropompën e ofruar, të lëshuar nga prodhuesi ose subjekti përgjegjës sipas

legjislacionit të zbatueshëm, është vendosur me qëllim garantimin dhe verifikimin e përputhshmërisë së pajisjes së ofertuar me kërkesat thelbësore të sigurisë, performancës dhe standardet teknike të aplikueshme për këtë kategori pajisjesh.

Elektropompa është një pajisje elektromekanike, funksionimi i së cilës përfshin ndërveprimin e komponentëve elektrikë, mekanikë dhe hidraulikë. Për këtë arsye, është e domosdoshme që pajisja e ofertuar të jetë projektuar, prodhuar dhe vendosur në treg në përputhje me kërkesat teknike dhe të sigurisë të zbatueshme për këtë lloj produkti.

Deklarata e Konformitetit përbën dokumentin nëpërmjet të cilit prodhuesi ose subjekti përgjegjës deklaron dhe merr përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit me kërkesat e legjislacionit, rregulloreve/direktivave dhe standardeve teknike të aplikueshme. Paraqitja e saj i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë se elektropompa e propozuar nuk është vetëm në përputhje me parametrat teknikë të kërkuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, por plotëson edhe kërkesat për sigurinë dhe konformitetin e produktit.

Kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë për faktin se elektropompa do të përdoret në kushte pune ku **siguria elektrike, qëndrueshmëria mekanike, funksionimi i vazhdueshëm dhe besueshmëria e pajisjes** janë elemente të rëndësishme për funksionimin normal dhe të sigurt të sistemit ku ajo do të instalohet.

Gjithashtu, kërkesa për Deklaratën e Konformitetit krijon një bazë të dokumentuar për verifikimin e origjinës dhe konformitetit teknik të produktit të ofertuar dhe redukton riskun e furnizimit me pajisje që nuk përmbushin kërkesat e detyrueshme teknike dhe të sigurisë.

Për sa më sipër, kërkesa për paraqitjen e Deklaratës së Konformitetit konsiderohet **e nevojshme, e lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe proporcionale me qëllimin që synohet të arrihet**, pasi garanton që elektropompa e ofertuar përmbush kërkesat e zbatueshme për konformitetin, sigurinë dhe standardet teknike, duke mbrojtur njëkohësisht interesin e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me pajisje të sigurta, të përshtatshme dhe të besueshme.

2.8 Elektropompa dhe të gjithë aksesorët përkatës të ofruar duhet të jenë në përputhje me certificate te sndarteve eurpiane CE) të aplikueshme për llojin dhe kategorinë përkatëse të produktit, ose standarde të tjera ekuivalente të njohura ndërkombëtarisht.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për tu siguruar se operatori do të përmbush kërkesat e

Argumentimi teknik i kriterit

Kërkesa që **elektropompa dhe të gjithë aksesorët përkatës të ofruar të jenë në përputhje me kërkesat e aplikueshme të Bashkimit Evropian për sigurinë dhe konformitetin e produkteve dhe, kur është e aplikueshme, të mbajnë markimin CE, si dhe të jenë në**

përputhje me standardet evropiane (EN) të aplikueshme ose standarde të tjera ekuivalente të njohura ndërkombëtarisht, është vendosur me qëllim garantimin e cilësisë, sigurisë, besueshmërisë dhe përshtatshmërisë teknike të pajisjeve që do të furnizohen.

Elektropompa është një pajisje elektromekanike, funksionimi i së cilës përfshin komponentë elektrikë, mekanikë dhe hidraulikë. Për këtë arsye, është e rëndësishme që pajisja dhe aksesorët që lidhen me instalimin dhe funksionimin e saj të plotësojnë kërkesat teknike dhe të sigurisë të aplikueshme për kategorinë përkatëse të produktit.

Përputhshmëria me kërkesat evropiane dhe standardet teknike të aplikueshme shërben për të garantuar që produktet janë projektuar dhe prodhuar duke respektuar kërkesat për **sigurinë elektrike dhe mekanike, qëndrueshmërinë, performancën dhe funksionimin e sigurt** në kushtet për të cilat janë destinuar.

Gjithashtu, kërkesa shtrihet edhe mbi **aksesorët përkatës**, pasi këta elementë janë pjesë e sistemit të instalimit dhe funksionimit të elektropompës. Përdorimi i aksesoreve të përshtatshëm dhe në përputhje me kërkesat teknike përkatëse ndikon në kompatibilitetin ndërmjet komponentëve, sigurinë e instalimit dhe reduktimin e riskut të defekteve ose problematikave gjatë shfrytëzimit të pajisjes.

Markimi **CE**, kur është i aplikueshëm për produktin konkret, tregon se prodhuesi ka vlerësuar përputhshmërinë e produktit me kërkesat përkatëse të legjislacionit të Bashkimit Evropian që zbatohen për të. Dokumentacioni i konformitetit i jep Autoritetit Kontraktor mundësinë të verifikojë në mënyrë të dokumentuar përmbushjen e këtyre kërkesave.

Parashikimi i **standardeve të tjera ekuivalente të njohura ndërkombëtarisht** synon njëkohësisht të ruajë konkurrencën dhe të mos kufizojë pjesëmarrjen vetëm te produkte që referojnë një standard të caktuar, për sa kohë operatori ekonomik provon se standardi ose zgjidhja e propozuar siguron një nivel të barasvlershëm të cilësisë, sigurisë dhe performancës teknike.

Për sa më sipër, kërkesa konsiderohet **e nevojshme, proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit**, pasi synon furnizimin e Autoritetit Kontraktor me një elektropompë dhe aksesorë të sigurt, të besueshëm, kompatibël dhe të përshtatshëm për përdorimin e parashikuar, pa krijuar kufizime të panevojshme për konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomi

2.9.Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik një deklaratë me anë të së cilës duhet të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit pranë AK, do të paraqesë certifikatën e origjinës , certifikatat e cilesise dhe garancise së mallrave, origjinale ose fotokopje të noterizuar të tyre, te cilat shërbejnë per te vertetuar respektimin e specifikimeve teknike , cilësine apo garancinë , që mallrat duhet të kenë , në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor.(Në zbatim te rekomandimit te APP nr 2106 date24.03.2021).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1, si dhe njoftimit të APP-së nr.prot 7459/4, datë 25.05.2021.

Argumentimi teknik i kriterit

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë në Sistemin e Prokurimit Elektronik një **deklaratë angazhimi**, nëpërmjet së cilës merr përsipër që në momentin e dorëzimit të mallrave pranë Autoritetit Kontraktor të paraqesë **certifikatën e origjinës, certifikatat e cilësisë dhe dokumentacionin e garancisë**, është vendosur me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë, cilësisë, përputhshmërisë teknike dhe mbulimit me garanci të mallrave që do të furnizohen.

Certifikata e origjinës shërben për identifikimin dhe dokumentimin e origjinës së mallrave të dorëzuara, duke i mundësuar Autoritetit Kontraktor të verifikojë që produktet e furnizuara korrespondojnë me produktet e deklaruara dhe të ofertuar nga operatori ekonomik.

Dokumentacioni/certifikatat e cilësisë shërbejnë për të verifikuar që mallrat e dorëzuara plotësojnë kërkesat për cilësinë dhe karakteristikat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke reduktuar riskun e pranimi të produkteve që nuk përmbushin parametrat dhe standardet e kërkuara.

Dokumentacioni i garancisë është i nevojshëm për të garantuar mbulimin e mallrave gjatë periudhës së përcaktuar të garancisë dhe për të siguruar përgjegjësinë përkatëse në rast të shfaqjes së defekteve apo problematikave teknike gjatë përdorimit të tyre.

Kërkesa është parashikuar në formën e një **deklarate në fazën e ofertimit**, ndërsa dokumentacioni përkatës kërkohet në momentin e dorëzimit të mallrave. Kjo mënyrë synon të mos rëndojë operatorët ekonomikë me dokumentacion të panevojshëm gjatë fazës së ofertimit, duke ruajtur njëkohësisht të drejtën e Autoritetit Kontraktor për të kryer kontrollin e dokumentacionit shoqërues të mallit në momentin e furnizimit.

Paraqitja e këtyre dokumenteve në fazën e dorëzimit krijon gjithashtu mundësinë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë se **malli i dorëzuar është ai i kontraktuar, plotëson kërkesat teknike dhe cilësore të përcaktuara dhe shoqërohet me garancinë përkatëse**, përpara pranimi përfundimtar të tij.

Për sa më sipër, kërkesa konsiderohet **e nevojshme, proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit**, pasi synon garantimin e cilësisë, gjurmueshmërisë dhe përputhshmërisë së mallrave të furnizuara me specifikimet teknike të Autoritetit Kontraktor, si dhe mbrojtjen e interesit të tij gjatë zbatimit të kontratës.

Kjo kërkesë është përcaktuar gjithashtu duke mbajtur në konsideratë **Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2106, datë 24.03.2021**, lidhur me dokumentacionin që vërteton respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë dhe garancinë e mallrave në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të përcaktuara për elektropompën e ujit dhe aksesoret përkatës janë hartuar në funksion të nevojave konkrete të Autoritetit Kontraktor, kushteve të punës dhe domosdoshmërisë për të siguruar një sistem të plotë, të sigurt dhe funksional për pompimin dhe transportin e ujit.

Parametrat teknikë të kërkuar janë përcaktuar duke marrë në konsideratë kapacitetin e nevojshëm të pompimit, lartësinë e dërgimit të ujit, presionin e punës, eficiencën e pajisjes, sigurinë elektrike, si dhe nevojën për instalimin dhe funksionimin e plotë të elektropompës.

Kontrolli automatik elektronik i funksionimit të pompës kërkohet për të mundësuar komandimin dhe kontrollin automatik të procesit të punës së elektropompës, duke ndihmuar në funksionimin e kontrolluar të pajisjes dhe në reduktimin e ndërhyrjeve manuale gjatë përdorimit.

Kërkesa për një **pompë me nivel të ulët zhurme** lidhet me nevojën për kufizimin e zhurmës gjatë funksionimit, veçanërisht në rastet kur pajisja instalohet ose funksionon pranë ambienteve të punës.

Prurja $Q = 130\text{--}170 \text{ l/min}$ ose $6\text{--}8 \text{ m}^3/\text{h}$ është përcaktuar në funksion të sasisë së ujit që kërkohet të transportohet në njësinë e kohës, me qëllim sigurimin e kapacitetit të nevojshëm të sistemit.

Lartësia manometrike $H = 16\text{--}25 \text{ m}$ është përcaktuar për të siguruar që elektropompa të jetë në gjendje të përballojë diferencën e nivelit dhe humbjet hidraulike që krijohen gjatë transportimit të ujit në sistem.

Presioni maksimal 6 bar kërkohet për të siguruar rezistencën dhe funksionimin e pajisjes në kushtet e presionit që mund të krijohen gjatë operimit të sistemit, duke garantuar një rezervë të përshtatshme sigurie dhe qëndrueshmërie.

Fuqia e pompës 0.9 kW është përcaktuar në raport me parametrat e kërkuar të prurjes dhe lartësisë manometrike, me qëllim sigurimin e performancës së nevojshme të pompimit dhe një funksionimi të përshtatshëm për destinacionin e pajisjes.

Kërkesa për **helikë prej inoksi** lidhet me nevojën për rezistencë ndaj korrozionit dhe lagështisë, qëndrueshmëri mekanike dhe jetëgjatësi të komponentit që është në kontakt të vazhdueshëm me ujin.

Argumentimi i aksesorëve

Aksesorët e parashikuar në specifikimet teknike janë të nevojshëm për **montimin, lidhjen elektrike dhe hidraulike, mbrojtjen dhe funksionimin e plotë të elektropompës**. Për këtë arsye, furnizimi i tyre së bashku me elektropompën siguron që pajisja të mund të instalohet dhe të vihet në funksion sipas destinacionit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Valvula 1" shërben për kontrollin dhe ndërprerjen e rrjedhës së ujit, duke mundësuar izolimin e linjës gjatë ndërhyrjeve, kontrollit apo mirëmbajtjes.

Lëshuesi 2P 25A, së bashku me elementët përkatës të instalimit elektrik, kërkohet për komandimin dhe mbrojtjen e furnizimit elektrik të elektropompës.

Kutia BM 3P, suporti 3P, kapaku 3P dhe Shuko 2P+T janë elementë të instalimit elektrik të nevojshëm për realizimin e lidhjeve dhe vendosjen e komponentëve në mënyrë të organizuar dhe të sigurt.

Elementët e tokëzimit, përfshirë elementin e tokëzimit 1.5 m, morsetat, telin e bakrit 35 mm² dhe elementin elektrik 3 m, janë parashikuar për realizimin e sistemit të tokëzimit dhe rritjen e sigurisë elektrike të instalimit, duke reduktuar rrezikun që mund të vijë nga defektet elektrike apo rrymat e padëshiruara.

Nipple 1", si element lidhës, është i nevojshëm për realizimin e lidhjeve të përshtatshme ndërmjet elektropompës dhe komponentëve të instalimit hidraulik.

Valvula e moskthimit 2", prej çeliku, me flanaxha, **PN 16 bar, Ø50**, kërkohet për të penguar kthimin e ujit në drejtim të kundërt pas ndalimit të pompës, duke mbrojtur pajisjen dhe duke ruajtur funksionimin korrekt të linjës. Presioni nominal PN16 siguron që elementi të ketë rezistencë të përshtatshme mekanike për përdorimin e parashikuar.

Xhuntoja antivibruese DN 1/2" është parashikuar për reduktimin e transmetimit të vibrimeve nga elektropompa drejt tubacionit dhe elementëve të tjerë të instalimit, duke kontribuar në mbrojtjen e lidhjeve dhe në funksionimin më të qëndrueshëm të sistemit.

Në tërësi, parametrat e elektropompës dhe aksesorët e kërkuar janë konceptuar si pjesë të një **sistemi të integruar pompimi**, ku çdo komponent ka funksion teknik të përcaktuar dhe kontribuon në instalimin, sigurinë, kontrollin dhe funksionimin e pajisjes.

Specifikimet janë përcaktuar në funksion të performancës së kërkuar dhe nevojave të Autoritetit Kontraktor dhe synojnë të sigurojnë që produkti përfundimtar të jetë **funksional, i sigurt, rezistent dhe i përshtatshëm për kushtet e përdorimit**, pa synuar favorizimin e një marke, prodhuesi apo modeli të caktuar.

Njësia e Prokurimit